Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

25.06.2018, Prishtinë,
Ref:19.03.2018\650-2018

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Suzana Rugovës kundër portalit Bota Sot

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 19 qershor 2018, shqyrtoi ankesën e Suzana Rugovës kundër portalit të gazetës Bota Sot lidhur me artikullin "Grupi i Rognerit që 20 vite po e mban peng Kosovën" publikuar më datë 29 maj 2018, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa miratohet pjesërisht

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se është shkelur Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës, Kreu IV (E drejta e përgjigjes), pika 2, dhe 3, dhe Kreu II (Raportimi i së vërtetës), pika 6.

Në përgjigjen e ish gazetarit të Botës Sot i cili e ka shkruar artikullin "Grupi i Rognerit që 20 vite po e mban peng Kosovën" publikuar më datë 29 maj 2018, thotë se artikullin e ka bërë duke u mbështetur në një shkrim të një publicisti. Sa i përket fotografisë së botuar, ai thotë "pajtohem edhe unë se fotografia nuk përputhet me përmbajtjen e artikullit, sepse përpos pamjes së hotelit Rogner, aty është vënë edhe Presidenti Hashim Thaqi, Kadri Veseli, dhe Xhavit Haliti".

KMShK konstatoi se në këtë rast është shkelur Kreu II (Raportimi i së vërtetës), pika 6, pasi fotografitë që botohen në media nuk guxojnë të falsifikohen apo të përdoren në mënyrë të gabueshme.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës